



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Mbrojtjen nga Zhurma.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Shpalljen e Rrjetit Ekologjik.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Fillon procesi i dekomisionimit dhe çmontimit të azotikut, gazifikimit, ngrohtores dhe objekteve tjera përcjellëse të cilat nuk e pengojnë operimin normal të njësive aktive.
2. Mbyllja e njësive aktive të TC Kosova A do të bëhet në përputhje me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës.
3. Procesi i çmontimit të njësive të TC Kosova A fillon menjëherë pas mbylljes së njësive aktive të TC Kosova A.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale Dimce, Komuna e Hanit të Elezit, e të cilat duhet të shpronësohen për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore të bartësit të licencës së lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), subjektit: Kompanisë Sharrcem SH.P. K, për sigurimin e lëndës së parë për prodhimin e çimentos dhe ushtrimin e të drejtave të tij në bazë të kësaj licence, sipas tabelës së bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme /Ministria e Financave.
3. Obligohet Kompania Sharrcem SH.P.K, -Hani i Elezit, për pagimin e kompensimit të shpronësimit të pronave të paluajtshme dhe shpenzimeve të procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit(MMPH), Ministria e Financave dhe Kompania "Sharrcem" Sh.P.K Hani e Elezit.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë për Integrim Evropian për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500,000.00 (pesëqind mijë) euro për sigurimin e këshillave ligjore dhe shërbimeve të ndërlidhura për përgatitjen e dokumentacionit dhe procedurave tjera përcjellëse për aplikim për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe mbarëvajtjen e procesit të negociatave për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga shpenzimet e paparashikuara të Qeverisë, kategoria ekonomike rezervat, dhe barten në administratën qendrore kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në Ministrinë e Integritimit Evropian.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria për Integrim Evropian për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 59 të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni *ad hoc* për për zgjedhjen e kandidatëve në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm në MZHE, Kryesues;
 - 1.2. Z. Fitim Sadiku, Sekretar i Përgjithshëm në MAP, anëtar;
 - 1.3. Z. Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm në MF, anëtar;
 - 1.4. Znj. Eljana Naka, Sekretare e Përgjithshme në MTI, anëtare dhe
 - 1.5. Z. Shkëlzen Syla, Sekretar i Përgjithshëm në MFSK, anëtar;
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi që ti kryej punët dhe detyrat në pajtim me Ligjin nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që brenda shtatë (7) ditësh të publikojë shpalljen për pozitat e lira në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunimin në Lehtësimin e Tregtisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në fushat e Transportit dhe Infrastrukturës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/156

Datë: 13.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 nr. 04/L-165 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-201, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për kursimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2013 në shumë prej €10,100,000 nga:
 - 1.1. Ministria e Infrastrukturës, nga ndarjet buxhetore kursen €10,100,000 si në vijim:
 - 1.1.1. €10,100,000, kursim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Ndërtimi i Autostradave, me kod 422, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "Ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit (R-6)", me kod 13256.
2. Aprovohet kërkesa buxhetore për mjete shtesë në shumë prej €10,100,000 për këto Organizata Buxhetore:
 - 2.1. Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i ndahen mjete shtesë në shumë prej €4,300,000 si në vijim:
 - 2.1.1. €4,300,000 ndarje buxhetore në nën-programin Zyra për Shpronësime me kod 605, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin "Shpronësimet" me kod 13130.
 - 2.2. Ndahen mjete shtesë në shumë prej €4,500,000 për Shpenzimet e Paparashikuara, si në vijim:
 - 2.2.1. €4,500,000 ndarje buxhetore në nën-programin Shpenzimet e Paparashikuara me kod 131, në kategorinë ekonomike Rezervat.

2.3. Komunat

2.3.1. Për Komunat e Republikës së Kosovës ndahen mjete në vlerë prej €1,300,000 sipas kësaj renditje:

- €500,000, në komunën e Ferizajit,
- €300,000 në komunën e Gjakovës,
- €300,000, në komunën e Pejës,
- €200,000 në komunën e Shtimes,

Obligohen Kuvendet Komunale që pas nxjerrjes së këtij vendimi brenda 3 ditësh të njoftojnë Ministrinë e Financave –Departamentin e Buxhetit Komunal për nën-programet dhe kategoritë se ku do të ndahen mjetet.

3. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për transferin e ndarjeve buxhetore nga një organizatë buxhetore në një organizatë tjetër buxhetore si vijon:

3.1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

3.1.1. €70,000, kursim i ndarjes buxhetore nga nën programi – Skema e Asistencës Sociale, nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, nga projektet:

- €40,000 nga projekti “Ndërtimi i Shtëpive për Komunitetin Hashkali në fshatin Dubravë të Ferizajt” dhe
- €30,000 nga projekti “Ndërtimi i Qendrës për Banim Social Podujevë”.

Shuma prej 70,000 transferohet në komunën e Klinës.


Obligohet Komuna e Klinës që pas nxjerrjes së këtij vendimi brenda 3 ditësh të njoftoj Ministrinë e Financave – Departamentin e Buxhetit Komunal për nën-programet dhe kategoritë se ku do të ndahen mjetet.

4. Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit fiskal dhe buxhetor nuk do të lejohen transfere mes kategorive ekonomike brenda një organizate buxhetore ose mes organizatave buxhetore, por do të lejohen brenda një organizate buxhetore vetëm transfere dhe rialokime brenda të njëjtës kategori ekonomike kur ka arsyeshmëri për një veprim të tillë.

5. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore, të cekura në pikën 2 të këtij Vendimi, që të sjellin në Ministrinë e Financave projektet kapitale individuale për financim.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Ministria e Financave dhe të gjitha organizatat buxhetore të ndikuara me këtë Vendim.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë